

## **Projektit LO Norway/ITUC/PERC dhe Shtetet e Ballkanit Perëndimor Zagreb – 1/4 tetor 2013**

Projekti Regjional i Sindikatave të Ballkanit Perëndimor i financuar nga Qeveria Norvegjeze dhe i cili është duke u implementuar nga Sindikatat Norvegjeze – LO Norway dhe ITUC/PERC zyra në Sarajevë) ku qëllimin kryesor e ka përmirësimin e gjendjes së Sistemit të Politikave të Taksimit, Ekonomisë Informale dhe Korrupsionit, në shtetet e Ballkanit Perëndimor, në drejtim të qeverisjes më të mire për proceset demokratike.

Në takim morën pjesë sindikalistë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor, siq janë Kosova, Shqipëria, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Bosna Hercegovina, Serbia etj. Takimi u mbajt në dy grupe paralele ku në grupin e parë morën pjesë ekspertët për komunikim ndërsa në grupin e dytë ekspertët e qështjeve juridike dhe ekonomike.

U dëgjuan shumë ligjërime nga përvoja e ekspertëve norvegjez z.Jens Schei Hanson, LO Norvegjisë i cili foli për mënyrën e ndërtimit të Strategjisë së Brendëshme dhe të Jashtme të informimit/komunikimit. Vlen të theksohet se kolegët e sindikatave norvegjeze na treguan se LO Norway e ka departmentin e Komunikimit i cili përmban 60 punëtorë, dhe janë të organizuar edhe në sindikatë të stafit brenda konfederatës, dhe kanë kryetarin dhe nënkryetarin e degës. Ata treguan një shembull të demokracisë së lartë ku ky department i komunikimit ka të drejt të kritikojë edhe liderët sindikal nëse e shohin gabimet gjatë punës së tyre, dmth të shkruajnë dhe të bëjnë vërejtje aty ku ata mendojnë se duhet dmth janë media tërësisht të pavarura edhe pse janë përbrenda Konfederatës LO Norway.

Gjithashtu vlen të përmendet se ata e publikojnë gazetën e tyre sindikale cdo muaj e cila ju shkon të gjithë anëtarëve sindikal në shtëpi, dhe pagesa për gazetën sindikale zbatohet në pagesën e anëtarësisë. Në këto gazeta sindikale ka më shumë foto dhe deklarata të punëtorëve/anëtarëve sindikal nëpër vendet e tyre të punës sesa foto dhe deklarata të liderëve sindikal. Sepse ekspertët e departmentit të komunikimit në LO Norway e kanë vërtetuar se më shumë ka interesim nëse punëtorët e thjeshtë i diksutojnë problemet nga vendi i tyre i punës me uniforma të punës sesa nëse të njëjtat deklarata i kumton një lider sindikal i cili flet nga zyra e tij dhe ka të veshur kostum me kravatë. Kjo ishte dallim shumë i madh nga revistat sindikale të shteteve të Ballkanit perëndimor dhe Turqisë ku në revistat dhe publikimet sindikale më shumë ka foto dhe shkrime të udhëheqësve se sa të punëtorëve të thjeshtë. Kjo ishte vërejtja e parë të cilën ekspertët norvegjez e kishin analizur në regjionin tonë.

Në grupin e dytë, të përbërë nga ekspertët e qështjeve juridike dhe ekonomike u bënë prezentimet e të gjitha shteteve ku u dhanë informata se në qfarë gjendje janë secili shtet ballkanit sa i përket Sistemit të taksave, Ekonomisë Joformale dhe Korrupsionit.

Një prezentim të shkëlqyeshëm lidhur me temën për Republikën e Kosovës e bëri eksperti për qështje financiare z. Ali Vitia i cili vjen nga Dega e Doganave të Kosovës, ku prezentimi i tij u cilësua si një prezentim shembull për shtetet tjera të rajonit nga eksperti i sindikatave Evropiane –ETUC z.Martin Htesbaut.

Takimi i radhës për këtë project do të mbahet në mars/prill të vitit 2014, ku deri atëhere ekspertët e qështjeve përkatëse duhet të prezentojnë edhe më në thellësi problemet e taksave, korrupsionit dhe të ekonomisë joformale ndërsa deri atëherë duhet të përgatitet edhe strategjia e Komunikimit të këtyre të dhënave nga secili shtet ku mandej kjo strategji do të inkorporohet në strategji regjionale duke marrë ngapak shembuj prej secilit shtet.